

**Armend MEHMETI**

Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Email: armend.mehmeti@gmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0000-0002-9904-0963>

KUD: 94(496.5-17)“1912/1939”(05)

**SHQIPËRIA E VERIUT NË PROJEKTET PUSHTUESE  
SERBE/JUGOSLLAVE (1912-1939): MIDIS AMBICIES  
DHE PËRMBAJTJES****Abstrakt:**

*Ambiciet dhe projektet serbe, e më pas jugosllave, për pushtimin e pjesës veriore të Shqipërisë dhe për sigurimin e një daljeje të mundshme në Adriatikun shqiptar kanë rrënjë të hershme dhe përbëjnë një element të vazhdueshëm në doktrinën e tyre gjeopolitike. Këto ambicie u artikuluuan fillimisht në platforma ideologjike dhe strategjike të shekullit XIX dhe u materializuan me përpjekje konkrete gjatë Luftërave Ballkanike (1912-1913), në kontekstin e Luftës së Parë Botërore, si dhe gjatë punimeve të Konferencës së Paqes në Paris (1919-1920), ku u diskutua gjerësisht rregullimi i kufijve dhe fati territorial i Shqipërisë. Megjithatë, rinjohja ndërkombëtare e pavarësisë së Shqipërisë dhe garantimi formal i integritetit të saj territorial kontribuuan në frenimin e përkohshëm të këtyre ambicieve, ato nuk u shuan plotësisht. Përkundrazi, ato mbetën aktive në qarqet politike e ushtarake të Beogradit dhe u ringjallën në fund të viteve 1930, në një kontekst të ri gjeopolitik të shënuar nga kriza e rendit evropian dhe rritja e influencës së fuqive fashiste. Në këtë kuadër, oferta italiane drejtuar Jugosllavisë për copëtimin e Shqipërisë u shndërrua në një moment kyç që nxiti debat dhe reflektim strategjik në udhëheqjen jugosllave. Me kërkesë të premierit Milan Stojadinoviç, qarqet politike, diplomatike dhe ushtarake jugosllave hartuan një varg elaboratesh dhe projektesh që trajtonin çështjen e Shqipërisë së Veriut, duke vlerësuar përfitimet e mundshme territoriale, si dhe rreziqet politike dhe ushtarake që një ndërmarrje e tillë do të sillte. Megjithatë, ndryshe nga periudhat e mëparshme, kur shteti serb dhe më pas ai jugosllav ishin përfshirë në aventura të rrezikshme ushtarake e diplomatike, udhëheqja supreme jugosllave në vitin 1939 tregoi një shkallë më të lartë përmbytjeje dhe pragmatizmi strategjik, duke hezitur të ndër-*

*marrë hapa konkretë drejt realizimit të këtyre ambicieve. Punimi “Shqipëria e Veriut në projektet serbe/jugosllave (1912-1939): midis ambicies dhe përmbajtjes” analizon në mënyrë të gjithanshme evolucionin e këtyre ambicieve, programet dhe elaboratet përkatëse, si dhe faktorët e brendshëm e ndërkombëtarë që ndikuan në formësimin apo frenimin e tyre. Studimi mbështetet në metodologjinë e analizës historike dhe krahasuese, të ndërtuar mbi parimin kronologjik, duke shfrytëzuar kryesisht literaturën dhe burimet arkivore të proveniencës shqiptare dhe jugosllave. Në aspekt strukturor punimi ndahet në katër shtylla duke paraqitur kështu një studim ndërdisiplinor dhe krahasues në baza të etapave historike dhe zhvillimeve diplomatike. Konkluzionet çojnë në argumentin se rrethanat gjeopolitike dhe balanca ndërkombëtare e fuqisë përbëjnë një element kyç në formësimin e relacioneve ndërkombëtare dhe rrjedhimisht në realizimin apo dështimin e ambicieve kombëtare. Ndryshe nga vitet 1912-1921, në fund të viteve 1930 Mbretëria e Jugosllavisë, pavarësisht ambicieve të ndërtuara prej dekadash, nuk ishte e gatshme politikisht, ushtarakisht dhe ekonomikisht për të ndjekur projekte për aneksimin e Shqipërisë së Veriut, duke kalkuluar gjithashtu rezistencën e faktorit shqiptar dhe pasojat potenciale në planin ndërkombëtar.*

**Fjalë kyç:** Adriatiku, ambicie, përmbajtje, Shqipëria, Stojadinoviç.

**Abstract:**

*The ambitions and projects of Serbia, and later Yugoslavia, to occupy the northern part of Albania and secure a possible access to the Albanian Adriatic have deep roots and constitute a continuous element in their geopolitical doctrine. These ambitions were initially articulated in the ideological and strategic platforms of the 19th century and materialized through concrete efforts during the Balkan Wars (1912-1913), in the context of the First World War, and during the proceedings of the Paris Peace Conference (1919-1920), where the regulation of borders and the territorial fate of Albania were widely discussed. Nevertheless, the international recognition of Albania's independence and the formal guarantee of its territorial integrity contributed to a temporary restraint of these ambitions, although they were not completely extinguished. On the contrary, they remained active within the political and military circles of Belgrade and were revived at the end of the 1930s, in a new geopolitical context marked by the crisis of the European order and the rise of fascist powers' influence. Within this framework, Italy's offer to Yugoslavia*

*for the partition of Albania became a key moment that sparked debate and strategic reflection within the Yugoslav leadership. At the request of Prime Minister Milan Stojadinović, political, diplomatic, and military circles in Yugoslavia drafted a series of reports and projects addressing the issue of Northern Albania, assessing the potential territorial gains as well as the political and military risks that such an undertaking would entail. However, unlike previous periods, when the Serbian and later Yugoslav state had engaged in risky military and diplomatic ventures, the supreme Yugoslav leadership in 1939 demonstrated a higher degree of restraint and strategic pragmatism, hesitating to take concrete steps toward realizing these ambitions. The study "Northern Albania in Serbian/Yugoslav Projects (1912-1939): Between Ambition and Restraint" comprehensively analyzes the evolution of these ambitions, the corresponding programs and reports, as well as the domestic and international factors that influenced their formation or curtailment. The study relies on the methodology of historical and comparative analysis, built on a chronological principle, primarily utilizing literature and archival sources of Albanian and Yugoslav provenance. Structurally, the paper is divided into four pillars, thus presenting an interdisciplinary and comparative study based on historical stages and diplomatic developments. The conclusions support the argument that geopolitical circumstances and the international balance of power are key elements in shaping international relations and, consequently, in the realization or failure of national ambitions. Unlike the period 1912-1921, by the late 1930s the Kingdom of Yugoslavia, despite ambitions built over decades, was not politically, militarily, or economically prepared to pursue projects for the annexation of Northern Albania, also taking into account Albanian resistance and the potential consequences on the international level.*

**Keywords:** Adriatic, ambitions, restraint, Albania, Stojadinović.

## Hyrje

Ardhja e Ilija Garashaninit<sup>1</sup> në krye të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Principatës së Serbisë dhe projekti i tij Naçertanija (1844), që vendoste kornizat e politikë së jashtme të Serbisë,<sup>2</sup> nënkuptonte fillimin e zbatimit të ambicieve ekspansioniste serbe. Sipas këtij projekti duhej të formohej një shtet i sllavëve me qendër Serbinë, që do të bazohej në shtetin mesjetar serb të shekujve XIII-XIV, duke vënë kështu në pah “të drejtën historike serbe”.<sup>3</sup> Në aspekt gjeografik ky shtet do të përfshinte përveç Serbisë dhe krahinave të Sremit, Baçkës e Banatit në veri të Ballkanit edhe Bosnjë e Hercegovinën, Malin e Zi, dhe Shqipërinë Veriore, ndërsa aspekti ekonomik-tregtar do të lehtësohej nga dalja e Serbisë në detin Adriatik, në veçanti në rajonin e Shkodrës e të Ulqinit.<sup>4</sup>

Padyshim, në një bashkim të tillë të sllavëve do të dominonin serbët.<sup>5</sup> Por, pasi që lëvizjet sllave në trevat e sunduara nga Austro-Hungaria u shtypën më 1849, ky akt i bëri të ditur Garashaninit se Austro-Hungaria ishte e fuqishme për Serbinë, prandaj projekti Naçertanija u orientua në drejtim të jugut, pra kundër trevave të banuara me shqiptarë nën sundimin osman. Kjo nënkupton edhe argumentin se nga kjo periudhë e tutje filloi politika ekspansioniste serbe kundër shqiptarëve dhe tokave të tyre.<sup>6</sup>

Konceptet e Garashaninit mbi çështjen serbe dhe të sllavëve të jugut, qoftë në anët pozitive apo negative, u pranuan nga të gjitha gjeneratat politike të borgjezisë serbe deri në vitin 1918 dhe më pas.<sup>7</sup> Zbatimi i synimeve të tilla u shoqërua me tipare të politikës gjenocidale, të cilat vendosjen e kontrollit mbi një territor e ndërlidhin me nevojën e spastrimit etnik. Spastrimi etnik fil-

---

<sup>1</sup> Ilija Garashanin (1812-1874) – politikan dhe burrështetas serb, ministër i Punëve të Jashtme të Principatës së Serbisë dhe hartues i projektit “Naçertanija”... për më tepër shih: Mehmet Kraja et.al, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës*, I, A-K (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2018), 475.

<sup>2</sup> Miroslav Krleža et.al, *Enciklopedija Jugoslavije* (Zagreb: Leksikografski Zavod FNRJ, 1958), 429.

<sup>3</sup> Драгослав Страњаковић, *Како је постало Гарашаниново «Начертаније»* (Београд: Споменик СКА, 1939), 76-102.

<sup>4</sup> *Po aty*.

<sup>5</sup> Hivzi Islami, *Spastrimet etnike-politika gjenocidiale serbe ndaj shqiptareve* (Pejë: Dukagjini, 2003), 17.

<sup>6</sup> Georges Castellan, *Histori e Ballkanit* (Tiranë: Çabej, 1997), 326.

<sup>7</sup> *Enciklopedija Jugoslavije*, 429.

loi qysh në dimrin e vitit 1877-1878 kur ushtritë serbe larguan rreth 200.000 shqiptarë nga Sanxhaku i Nishit,<sup>8</sup> territor që iu njoh Serbisë me vendimet e Kongresit të Berlinit të vitit 1878.

Aneksimi i Sanxhakut të Nishit bërë që Serbia të konsideronte zgjerimin e mëtutjeshëm territorial në drejtim të jugut, respektivisht kundrejt Maqedonisë, Sanxhakut të Novi Pazarit, Kosovës dhe territoreve në veri të Shqipërisë.<sup>9</sup> Për të arsyetuar këto synime, Jovan Cvijiç, njëri ndër ideologët kryesor të zgjerimit të shtetit serb, pohonte se Kongresi i Berlinit i vitit 1878 e kishte lënë Serbinë një “vend të rrethuar”, prandaj ajo duhej të dilte në det. Nën drejtimin e Cvijiçit qeveria serbe kishte përgatitur një studim të detajuar mbi territorin e “Serbisë së Vjetër”.<sup>10</sup> Emërtimi “Serbia e Vjetër” si një term gjeografik që lindi në shekullin XIX nënkuptonte një sipërfaqe prej 40.000 km<sup>2</sup> të territoreve të sotme të Maqedonisë Veriore, Kosovës dhe të Sanxhakut të Novi Pazarit, të cilat pretendoheshin si treva të Serbisë mesjetare.<sup>11</sup> Dhe, pikërisht në këtë territor të përcaktuar më lart, kalonin rrugët kryesore që të çonin drejt Mesdheut dhe Adriatikut, respektivisht pozita gjeografike ishte e tillë sa që i jepte zotëruesit të saj edhe tipare të karakterit strategjik gjeopolitik, ushtarak dhe ekonomik.

## **Përpjekjet për dalje në Adriatikon shqiptar 1913-1921**

Rrethanat e krijuara gjatë fundit të dekadës së parë të shekullit njëzetë krijuan një terren të përshtatshëm për realizimin nga Serbia të ideve të Jovan Cvijiçit. Aneksimi i Bosnjë-Hercegovinës nga Austro-Hungaria më 1908 përfundimisht i mbylli rrugën Serbisë për dalje në det nga ana e saj perëndimore, prandaj alternativa e vetme mbeti dalja në Adriatikon shqiptar.<sup>12</sup>

<sup>8</sup> Sabit Uka, “Planet antishqiptare të shteteve fqinje në shekullin XIX”, *Shqiptarët në rrjedhat ballkanike* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1996), 162.

<sup>9</sup> Erhan Turbedar, “Understanding ambitious and expansionist approaches in the process leading to the Balkan Wars through the Railway example”, *The Centenary of Balkan Wars (1912-1913)*, Vol. 2, ed. Mustafa Turkeç (Ankara: Turk Tarih Kurumu, 2014), 884.

<sup>10</sup> Михаило Војводић, *Србија и Албанско питање крајем XIX Века*, vol. Књига 15 (Београд: Српска Академија Наука и Уметности, Одељење Историјских Наука, 1990), 94-95.

<sup>11</sup> Јевто Дедијер, “Стара Србија географска и етнографска слика (1912.)”, qasur më 10 prill 2023, <https://dokumen.tips/download/link/dr-jevto-dedijer-stara-srbija-geografaska-i-etnografaska-slika.html>

<sup>12</sup> Sabri Rexha, *Raportet shqiptaro-serbe në Kosovë* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011), 97-98.

Në anën tjetër, në trevat e banuara me shqiptarë mbizotëronte një gjendje e trazuar politike. Dështimet e qeverisë osmane për të plotësuar kërkesat shqiptare rezultuan me një kryengritje të përgjithshme shqiptare që kishte filluar në pranverë të vitit 1912 në Kosovë. e që kulmin e kishte arritur në korrik të po këtij viti, me hyrjen e kryengritësve shqiptarë në Shkup,<sup>13</sup> qendër e vilajetit të Kosovës. Ky akt rrezikonte interesat e monarkive ballkanike të Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë e Greqisë, të cilat qysh më herët kishin bërë plane për copëtimin e Ballkanit nën argumentin e kritereve të ndryshme kulturore, gjuhësore e historike.<sup>14</sup> Shtetet ballkanike lidhën midis tyre aleanca politike e ushtarake, të cilat u quajtën Aleanca Ballkanike, dhe në tetor të vitit 1912 i shpallën luftë Perandorisë Osmane.<sup>15</sup>

Në fillim të tetorit 1912 serbët filluan depërtimin në drejtim të jugut. Më 5-6 tetor forcat serbe thyen rezistencën shqiptare në Merdar dhe arritën në Prishtinë.<sup>16</sup> Gradualisht ata pushtuan territore tjera, dhe përkundër rezistencës shqiptare, në saje të organizimit dhe superioritetit ushtarak, më 26 – 28 nëntor pushtuan Krujë, Tiranën dhe Durrësin, për të dalë kështu në Adriatik.<sup>17</sup> Në këto rrethana në Vlorë u mbledh një Kuvend Kombëtar përmes së cilit më 28 nëntor 1912 Ismail Qemali shpalli pavarësinë e Shqipërisë, dhe kërkoi mbrojtje “kundër të gjitha sulmeve ndaj ekzistencës së saj kombëtare dhe kundër çdo copëtimi të këtij shteti”.<sup>18</sup> Megjithatë, shpallja e pavarësisë nuk i pengoi ushtritë ballkanike në pushtimin e tokave shqiptare, sidomos të porteve detare. Për të përligjur pushtimet e tyre, kryeministri serb deklaronte se “një Shqipëri e pavarur nuk është as e dëshirueshme e as e mundur”, ndërsa

<sup>13</sup> Më 30 korrik 1912 rreth 50.000 kryengritës shqiptarë hynë në Shkup dhe parashtruan këto kërkesa: bashkimin e katër vilajeteve (të Kosovës, Manastirit, Shkodrës dhe të Janinës në një vilajet të vetëm; gjuha shqipe të ishte gjuhë e administratës në këtë vilajet; ushtarët shqiptarë të shërbenin në trevat e tyre, etj., për të cilat pala osmane u pajtua në parim... për më tepër shih: L. S. Stavrianos, *The Balkans since 1453* (London: Hurst, 2002), 509.

<sup>14</sup> Richard C. Hall, *The Balkan Wars 1912-1913: Prelude to the First World War* (London, New York: Routledge, 2000), 4-5.

<sup>15</sup> *British Documents on the Origin of the War 1898-1914, Vol. IX, Part I*, ed. G.P. Gooch & Harold Temperley, (London: H.M. Stationery Office, 1933), 1.

<sup>16</sup> Милутин Д. Лазаревић, Наши ратови за ослобођење и уједињење. Српско-Турски рат 1912. године, књ. II (Београд: Српска Књижевна Задруга, 1929), 3.

<sup>17</sup> Liman Rushiti, “Rezistenca e popullit shqiptar kundër pushtuesve serbo-malazezë 1912-1914”, *Kosova* 24-25/2002-2003 (2003): 162.

<sup>18</sup> Ismail Qemal Vlora, *Kujtime* (Tiranë: Botimet Toeana, 1997), 315; Castellan, *Histori e Ballkanit*, 396; Stavrianos, f. 509. Stavrianos, *The Balkans since 1453*, 509.

shtypi grek shkruante se “është për t’u shqetësuar lejimi i barbarëve shqiptarë për një ekzistencë të pavarur në mes të civilizimit grek”.<sup>19</sup>

Për t’i dhënë fund luftës, në pjesën e dytë të dhjetorit 1912 filloi në Londër punimet Konferenca e Ambasadorëve (Britanisë së Madhe, Francës, Ruisë, Italisë, Austro-Hungarisë e Gjermanisë), e cila qysh në fillim të punimeve njohu autonominë e Shqipërisë dhe të drejtën e Serbisë për një dalje tregtare në Adriatik.<sup>20</sup> Më 29 korrik 1913 Konferenca e Ambasadorëve njohu Shqipërinë principatë autonome, sovrane e të trashëgueshme, por jashtë kufijve të saj mbetën gjysma e trevave dhe e popullsisë shqiptare.<sup>21</sup>

Gjatë okupimit ushtarak serb, këta të fundit ishin përpjekur që t’i përligjin pretendimet territoriale serbe për Adriatikon shqiptar me mungesën e daljes në det dhe me disa harta që e tregonin popullsinë e veriut të Shqipërisë si të përzier serbo-shqiptare, ndonëse këto krahina kishin një popullsi e pastër shqiptare.<sup>22</sup> Presioni i Fuqive të Mëdha, sidomos kërcënimi ushtarak austro-hungarez, bëri që në tetor të vitit 1913 qeveria serbe të urdhëronte ushtrinë e saj që të tërhiqej nga territoret e shtetit shqiptar të njohur nga Konferenca e Londrës,<sup>23</sup> ndërsa këmbëngulja austro-hungareze po ashtu ndikoi që çështja e daljes së Serbisë në Adriatik të mos realizohej.<sup>24</sup>

Gjatë Luftës së Parë Botërore projektet ekspansioniste serbe ishin përmbledhur në dy versione: atë maksimal, që përveç Bosnjë-Hercegovinës përfshinte edhe të gjitha viset tjera të banuara nga sllavët nën sundimin austro-hungarez, dhe atë minimal që nënkuptonte një Serbi të zgjeruar.<sup>25</sup> Sidoqoftë, në kuadër të njërit apo tjetrit version hynte pashmangshëm edhe aneksimi i veriut të Shqipërisë dhe dalja në Adriatikon shqiptar. Në kuadër të këtyre synimeve, vetëm gjatë viteve 1914 dhe 1915 u nënshkruan dy marrëveshje midis Esat Pashë Toptanit dhe qeverisë serbe. Derisa marrëveshja e vitit 1914 parashihte ngritjen e institucioneve të përbashkëta politike-ushtarake dhe ndërtimin e një hekurudhe që do ta lidhte Serbinë me Adriatikon, ajo e vitit 1915 parashihte

<sup>19</sup> Po aty.

<sup>20</sup> Arben Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha* (Tiranë: Toena, 2012), 143.

<sup>21</sup> Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 1992), 9.

<sup>22</sup> Pierre Cabanes et.al, *Historia e Adriatikut* (Tiranë: Shtëpia botuese IDK, 2005), 471-472.

<sup>23</sup> Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha*, 362.

<sup>24</sup> Po aty, 202.

<sup>25</sup> Bogdan Krizman, *Vanjska politika jugoslovenske države 1919-1941- Diplomatski istorijski pregled* (Zagreb, 1975), 6.

korrigjime kufitare në favor të Serbisë, bashkimin doganor dhe ekonomik midis Shqipërisë dhe Serbisë dhe aneksimin nga Serbia të trevave shqiptare të Pogradecit, Gollobërdës, Dibrës së Madhe, Hasit e Lumës.<sup>26</sup>

Në përfundim të Luftës së Parë Botërore ushtritë serbe mbanin të okupuara territore veriore shqiptare si Dibra, Hasi, Luma, Malësia e Gjakovës, etj.,<sup>27</sup> me synimin e aneksimit të tyre në bazë të marrëveshjes së arritur në vitet 1914-1915 ndërmjet Serbisë dhe Esat Pashë Toptanit.<sup>28</sup> Në fakt, ky territor që u pagëzua si “vija strategjike” zinte afro 1/6 e sipërfaqes së përgjithshme të Shqipërisë së vitit 1913, me një popullsi prej 150.000 banorësh.<sup>29</sup>

Pretendimet për aneksimin e trevave veriore shqiptare dhe daljen në Adriatik qeveria serbe-kroate-slllovene<sup>30</sup> u përpoq t'i realizonte në dy linja: atë lokale dhe ndërkombëtare. Në aspekt lokal gjatë muajve të parë të pushtimit qeveria SKS u përqendrua në forcimin e pozitave në viset e pushtuara. Konsolidimi i regjimit nënkuptonte shuarjen e çfarëdo rezistence dhe me krijimin e rrethanave edhe të aneksimit të territoreve tjera shqiptare me miratimin e Fuqive të Mëdha. Për të krijuar bindje në Konferencën e Paqes e jashtë saj, qeveria SKS ndërmori një fushatë kërcënimesh e presionesh ndaj popullsisë së zonave të pushtuara për ta detyruar të shprehej “vullnetarisht” për bashkimin me Mbretërinë SKS.<sup>31</sup>

Në aspektin ndërkombëtar, qeveria SKS në Konferencën e Paqes në Paris mbronte qëndrimin për një Shqipëri me kufij të vitit 1913, me kërkesën se nëse Italisë i njihej protektorati mbi Shqipërinë ose mbi një pjesë të saj, ose edhe mbi Vlorën, që “*edhe Mbretërisë SKS t'i jepeshin viset veriore deri te*

<sup>26</sup> Dušan T. Bataković, *Qeveria serbe dhe Esat Pashe Toptani* (Tiranë: Botimet IDK, 2012), 27-35.

<sup>27</sup> Muin Çami, M. Verli, *Shqipëria ne Konferencen e Paqes (1919-1920)* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2015), 67-68; Vuk Vinaver, “Italijska akcija protiv Jugoslavije na albanskoj-crnogorskoj granici 1918-1920”, *Istorijski zapisi* 3-1966 (1966): 478.

<sup>28</sup> Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1919-1927* (Tiranë: Botimet enciklopedike, 1992), 46.

<sup>29</sup> Lush Culaj, *Çështja shqiptare ne Konferencën e Parisit 1919-1920* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2010), 19.

<sup>30</sup> Më 1 dhjetor 1918 Aleksandër Karagjorgjeviç shpalli Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Slllovenëve (më tej: SKS). Ky shtet ishte bashkim midis Serbisë dhe Këshillit Kombëtar Serb-Kroat-Sllloven (trevave të banuara me sllavë nën okupim të Austro-Hungarisë, me kryeqytet Beogradin. Ushtria serbe u shndërrua në ushtri të Mbretërisë SKS, serbët mbanin pozitën më të rëndësishme në administratën e këtij shteti, ndërsa formacionet ushtarake kroate u shpartalluan... për më tepër shih: Margaret Mcmillan, *Paris 1919 gashtë muaj që ndryshuan botën* (Tiranë: Plejad, 2006), 149.

<sup>31</sup> Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1919-1927*, 55.

*lumi Drin, në mënyrë që të mbrohet kufiri jugor i Mbretërisë SKS*".<sup>32</sup> Pavarësisht këtij qëndrimi, më 13 janar 1920 Franca dhe Britania e Madhe, duke shfrytëzuar rrethanat e brendshme politike në SHBA që ndërlihdeshin me shëndetin e Presidentit Uilson dhe me dështimin e Senatit Amerikan për të miratuar Traktatin e Versajës, u përpoqën t'i rikonfigurojnë interesat e tyre në "Çështjen e Adriatikut" përmes copëtimit të Shqipërisë dhe rregullimit të çështjeve të hapura në Azinë e Vogël.<sup>33</sup>

Në këtë kontekst, ata i bënë një propozim konkret delegacionit të Mbretërisë SKS që bazohej në Traktatin e Fshehtë të vitit 1915:<sup>34</sup> Shqipëria copëtohej midis tre vendeve fqinje: Italisë i njihej Vlora, pjesa veriore e Shqipërisë i jepej Mbretërisë SKS, ndërsa Korça e Gjirokastra i jepeshin Greqisë.<sup>35</sup> Kryeministri francez i pohonte delegacionit jugosllav se: "... dhe mbi të gjitha ju do ta keni Shkodrën, Drinin dhe Shëngjinin. Mua më duket se të gjitha këto përbëjnë avantazhe të konsiderueshme".<sup>36</sup> Duke qenë se delegacioni i Mbretërisë SKS ishte heterogjen dhe përbëhej përveç serbëve edhe nga sllovenët e kroatët, këta të fundit nuk e shihnin me dashamirësi flijimin e Fiumes për Shkodrën. Për të ruajtur unitetin e shtetit delegacioni i Mbretërisë SKS hodhi poshtë propozimin franko-britanik.<sup>37</sup>

Ky akt i delegacionit jugosllav u mbështet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat ishin kundër marrëveshjeve të fshehta dhe mbështesnin parimin që rregullimi politik i Ballkanit të bëhej në bazë të linjave historike dhe përkatësisë kombëtare, duke garantuar pavarësinë politike e ekonomike

<sup>32</sup> B. Krizman, Bogumilj Hrabak, *Zapisnici sa sednica delegacije Kraljevine SHS na Mirovnoj Konferenciji u Parizu 1818-1920* (Beograd: Institut Društvenih Nauka, 1960), 365-366; D. Todorović, *Jugoslavija i Balkanske Države 1918-1923* (Beograd: Institut za Savremenu Istoriju, 1979), 50.

<sup>33</sup> Arber Hadri, *Presidenti Vilson dhe çështja shqiptare (Politika e SHBA në Konferencën e Paqes në Paris 1919-1920)* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2012), 153.

<sup>34</sup> Në prill të vitit 1915 Britania e Madhe, Franca, Rusia e Italia nënshkruan Traktatin e Londrës përmes së cilit Italia rreshtohet në anën e Antantës. Dispozitat e këtij traktati lidhur me Shqipërinë mund të përmblihdhen: "Shqipëria e njohur ndërkombtarisht më 1913 do të ndahet në këtë mënyrë: Vlora dhe rrethina do të bien nën sovranitetin e plotë të Italisë; në Shqipërinë Qendrore do të formohet një shtet autonom shqiptar nën protektoratin italian; Shqipëria Veriore i jepej Serbisë e Malit të Zi, kurse Shqipëria Jugore Greqisë..." për më tepër shih: *The National Archives* (më tej: TNA), Fondi: 371/5726, 1921, 229.

<sup>35</sup> Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një mbretërie* (Tiranë: Dituria, 2005), 250-251.

<sup>36</sup> Ferdo Šišić, *Jadransko pitanje na Konferenciji Mira u Parizu, Zbirka akata i dokumenata* (Zagreb: Izvanredno izdanje matice Hrvatske, 1920), 83.

<sup>37</sup> Krizman, Hrabak, *Zapisnici sa sednica delegacije Kraljevine SHS...*, 237.

dhe integritetin territorial të shteteve ballkanike.<sup>38</sup> Presidenti Uilson propozoi bisedime të drejtpërdrejta midis Italisë e Mbretërisë SKS, si të vetmen mënyrë për të zgjidhur problemet midis tyre.<sup>39</sup> Ky akt bëri që Shqipëria të ndahej nga “Çështja e Adriatikut” dhe si rrjedhojë të shpëtonte nga copëtimi.

Megjithatë, duke parë që Fuqitë e Mëdha po i afroreshin një vendimi rreth kufijve të Shqipërisë të cilat nuk do të shkonin në favor të Beogradit, kjo e fundit kah fundi i tetorit 1921 vendosi që të organizojë një fushatë ushtarake për të pushtuar veriun e Shqipërisë në mënyrë që t’i vë Fuqitë e Mëdha para aktit të kryer. Ato pushtuan Lurën, Oroshin, Shëngjinin dhe Lezhën, ndërsa njëkohësisht më 5 nëntor 1921 paraqitën në Konferencën e Ambasadorëve kërkesat: 1) nevojën për kufij mbrojtës; 2) kalimin e një hekurudhe serbe përmes Shqipërisë së Veriut deri në Adriatik; 3) të lejohej Mirdita që të formonte republikën e saj, dhe 4) t’i njiheshin Jugosllavisë interesat predominante në Shqipëri.<sup>40</sup>

Fuqitë e Mëdha nuk ishin të vullnetit të futeshin në shtjellimin e kërkesave të qeverisë SKS. Më 9 nëntor 1921 Konferenca e Ambasadorëve komunikoi vendimet e saj lidhur me kufijtë e Shqipërisë. Lidhur me kufijtë veriorë të Shqipërisë, Konferenca vendosi: korigjimin e kufijve shqiptarë në verilindje të Shkodrës, në perëndim dhe në jug të Prizrenit, në perëndim dhe juglindje të Dibrës dhe në rajonin e Linit në liqenin e Ohrit. Ky korigjim do të linte jashtë shtetit shqiptar një pjesë të krahinës së Lumës, Hasit dhe Gollobërdës, me një popullsi prej 40.000 vetash, të cilat përfshiheshin në MSKS.<sup>41</sup>

Pavarësisht që as Shqipëria e as Mbretëria SKS nuk ishin të kënaqura nga ky vendim i Konferencës së Ambasadorëve, kuptohet nga pozita të kundërta, Beogradi nuk arriti të realizonte synimet e plota kurse Shqipërisë i shkëputeshin disa territore, megjithatë vendimi duhej zbatuar. Konferenca e Ambasadorëve kërkoi nga qeveria e Mbretërisë SKS që të urdhëronte tërheqjen e trupave të saj nga territoret që i atribuohen Shqipërisë në bazë të këtij vendimi.<sup>42</sup>

<sup>38</sup> Hadri, *Presidenti Wilson dhe çështja shqiptare*, 31-33.

<sup>39</sup> Haris Sulajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit* (Tiranë: Dituria, 1991), 116-117; Albert Mousset, *Shqipëria përballë Evropës (1912-1929)* (Tiranë: Dituria, 2004), 26.

<sup>40</sup> Pranvera Dibra-Teli, *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927* (Tiranë: Neraida, 2005), 181-182.

<sup>41</sup> *Arkivi i Kosovës* (më tej AK), Fondi: P. Millovanoviç-Beograd, nr. inv. 132, kutia 3, Revista e Lidhjes së Kombeve, 1195; P. Dibra, “Diplomacia angleze dhe vendimi i 9 nëntorit të vitit 1921 për Shqipërinë”, *Studime Historike* 3-4/2002 (2002): 56.

<sup>42</sup> TNA, Fondi: FO 371/5735, League of Nations, 18 nëntor 1921, 68.

## Ndryshimi i rrethanave gjeopolitike në Evropë

Pas dështimit të përpjekjeve për të pushtuar veriun e Shqipërisë dhe rrjedhimisht daljen në Adriatikun shqiptar, Mbretëria e SKS, e cila më vonë u emërtua në Mbretëria e Jugosllavisë, ndoqi një politikë që konsistonte në pengimin e konsolidimit dhe të prosperitetit të shtetit shqiptar, për të dëshmuar më pas se kjo e fundit nuk ishte në gjendje të vetëqeverisej.<sup>43</sup>

Në kuadër të kësaj politike ajo shfrytëzoi agjenturat e saj për të destabilizuar Shqipërinë. Qeveria jugosllave ishte e përfshirë në rikthimin e Ahmet Zogut në krye të shtetit shqiptar (dhjetor 1924) e më pas edhe në kryengritjen e Dukagjinit (nëntor 1926), etj., të cilat detyruan Zogun që të rreshtohet gjithnjë e më shumë në krah të Italisë. Pakti i Parë i Tiranës (1926) dhe Pakti i Dytë i Tiranës (1927), si pakt ushtarak e mbrojtës, të shoqëruara me kredi dhe ndihma të ndryshme financiare përforcuan shtrirjen e ndikimit italian mbi Shqipërinë.<sup>44</sup>

Vitet e 30'-ta u karakterizuan me shfaqjen e ambicieve të hapura ekspansioniste të Italisë dhe të Gjermanisë dhe me tolerancën e demokracive perëndimore karshi ambicieve të tilla. Pakti i katër fuqive: Francës, Britanisë së Madhe, Italisë e Gjermanisë, i nënshkruar në korrik të vitit 1933,<sup>45</sup> kishte alarmuar vendet ballkanike të cilat kërcënoheshin drejtpërdrejt nga pretendimet italiane e gjermane.

Jugosllavia e cila në politikën e saj të jashtme bazohej në Francën kishte filluar të shprehte dyshime në sinqeritetin francez. Në politikën e jashtme jugosllave shihej ftohja me Francën pasi që ajo po tentonte të përfitonte nga Italia, ndërsa Italia shihej në Jugosllavi si fuqi që po tentonte ta rrëronte Jugosllavinë për të shtrirë ndikimin e saj në rajonin e Danubit dhe në hapësirën e Mesdheut, me synimet për të përtërirë Perandorinë Romake.<sup>46</sup> Ftohja u thellua sidomos në tetor të vitit 1934, kur në Marsej të Francës ishte vrarë mbreti jugosllav Aleksandri. Shtypi jugosllav i kohës shkruante se Franca nuk

<sup>43</sup> AK, Fondi: Arkivi i ish ushtrisë së Jugosllavisë, Elaborat 20, Popisnik 17, vitet 1920-1941; Swire, *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, 268.

<sup>44</sup> Kristaq Prifti et.al, *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007), 238-275.

<sup>45</sup> *Foreign Relations of the United States Diplomatic Papers*, General Volume I (*Washington: US Printing House 1933*), 396.

<sup>46</sup> Dušan Lukać, *Treći Rajh i zemlje jugoistočne Evrope*, Prvi deo 1933-1936 (Beograd, 1982, 68-78.

i kishte marrë masat e duhura për të parandaluar një akt të tillë,<sup>47</sup> e aq më tepër nuk e kishte mbështetur Jugosllavinë në nismën e saj në Lidhje të Kombeve për fajësimin e Hungarisë lidhur me vrasjen e mbretit Aleksandër.<sup>48</sup>

Në fakt, ngjarjet që pasuan dëshmuar se ndryshimi i rrethanave gjeopolitike në Evropë veçse kishte filluar. Kryeministri jugosllav, Milan Stojadinović, njëkohësisht edhe ministër i Jashtëm, i cili mandatin qeveritar e mori më 1935, në vend të aleancës me Francën dhe Antantën Ballkanike, e orientoi politikën e tij të jashtme në drejtim të Boshtit Berlin-Romë.<sup>49</sup> Tani prioritetet kryesore në politikën e jashtme jugosllave ishin ruajtja e integritetit të vendit dhe afrimi me Romën, me kusht që raportet e mira me Berlinin të shërbenin si siguri kundër fqinjit të pasigurt italian.<sup>50</sup>

Orientimi në drejtim të Boshtit u shoqërua rrjedhimisht edhe me ndryshimin e qëndrimit ndaj Shqipërisë. Ndryshe nga vitet 20', në fillim të viteve 30' të shekullit XX, Jugosllavia përmes marrëveshjeve tregtare ishte përpjekur ta mbështeste Shqipërinë që mos të rrëshqiste plotësisht nën influencën italiane. Por, marrëveshjet shqiptaro-italiane të vitit 1936, që përfshinin ndihma financiare, kredi, ndërtime infrastrukturore, etj.,<sup>51</sup> nuk u pritën mirë në Beograd. Ishte e qartë se Italia po përgatiste terrenin për nënshtrimin e Shqipërisë dhe depërtimin e mëtutjeshëm në Ballkan. Në rrethana të tilla qeveria jugosllave nuk veproi sikurse në të kaluarën kur në kundërpërgjigje të veprimeve italiane ishte përpjekur ta ndihmonte Shqipërinë. Ajo nuk i mbajti premtimet për ndihmë financiare, nuk e hapi tregun për mallrat shqiptare dhe nuk e hoqi mbështetjen për kundërshtarët e mbretit Zog në emigracion.<sup>52</sup> Për më tepër, ajo tani ishte e prirë të bisedonte me Italinë lidhur me interesat e përbashkëta, por edhe me perspektivat e reja kundrejt Shqipërisë. Në rastin e parë, që të dyja shtetet i frikësoheshin rrezikut gjerman. Në bisedimet e vjeshtës së vitit 1936, ministrat e jashtëm të dyja vendeve, Ciano dhe Stojadinović, kishin ardhur në përfundim se do të kishin një pozicion më të fuqishëm së bashku, se sa veç e veç kundrejt Gjermanisë.<sup>53</sup> Në rastin e dytë, për shkak të interesimit

<sup>47</sup> Ferdo Čulinović, *Jugoslavija između dva rata*, Knjiga II (Zagreb: Jugoslovenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, 1961), 65-67.

<sup>48</sup> Milan Stojadinović, *Ni rat ni pakt, Jugoslavia između dva rata* (Buenos Aires, 1963), 35.

<sup>49</sup> Milan Vanku, *Mala Antanta 1920-1938* (Titovo Užice, 1969), 129.

<sup>50</sup> Krizman, *Vanjska politika jugoslovenske države 1919-1941*, 83.

<sup>51</sup> Prifti et.al, *Historia e Popullit Shqiptar*, 475-476.

<sup>52</sup> Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë* (Tiranë: Toena, 2013), 845-846.

<sup>53</sup> Vanku, *Mala Antanta 1920-1938*, 175.

të të dyja vendeve, Shqipëria ishte bërë njëra nga temat kryesore në bisedimet midis qeverisë italiane dhe asaj jugosllave, që u zhvilluan gjatë fundit të vitit 1936 dhe fillimit të vitit 1937.

Më 25 mars 1937 Italia dhe Jugosllavia nënshkruan marrëveshjen për miqësi dhe tregti. Marrëveshja përbëhej prej dy pjesëve: anës politike dhe asaj ekonomike, që përmbli dhej në plotësimin e disa marrëveshjeve ekzistuese. Në planin politik palët u pajtuan për respektimin e kufijve të njëra-tjetrës dhe moslejimin që territori i tyre të përdorej nga fuqitë e tjera për ta sulmuar ndonjëherë prej tyre.<sup>54</sup>

Sigurisht që në këtë marrëveshje nuk mund të anashkalohej trajtimi i Shqipërisë si një çështje që për vite me radhë i kishte preokupuar këto dy vende. Burimet jugosllave theksonin se përmes kësaj marrëveshjeje Jugosllavia u solidarizua me politikën fashiste italiane në Shqipëri duke pranuar *status quo*-në dhe duke u zotuar se asnjë ndryshim nuk mund të ndodhte në Shqipëri pa miratimin e të dy vendeve.<sup>55</sup> Sipas historianit jugosllav Avramovski, korrespondenca sekrete diplomatike italo-jugosllave la të kuptohej se qeveria e Stojdinoviçit kishte pranuar pozitën mbizotëruese italiane në Shqipëri, respektivisht kishte pranuar interpretimin italian të këtij pakti se Shqipëria e kishte humbur tanimë rëndësinë që kishte ajo në marrëdhëniet italo-jugosllave.<sup>56</sup>

Marrëveshja në fjalë kishte shkaktuar ankth në Tiranë. Sipas ministrit britanik në Shqipëri, në qarqet zyrtare në Tiranë po mbizotëronte një heshtje e madhe lidhur me mirëkuptimin italo-jugosllav për Shqipërinë. Autoritetet e Tiranës i kishin ndaluar shtypit të trajtonin çështjet të cilat ishin të trajtuara në gazetatat evropiane. Ministri në fjalë komentonte se heshtja mund të ishte rezultat i mungesës së sqarimeve mbi qëllimet e dy fuqive, si dhe fyerje për shkak se mirëkuptime të tilla po lidheshin mbi kokën e Shqipërisë, si dhe ngurrimit që këtë fakt t'ia publikonin opinionit publik, se Shqipëria po trajtohet si figurë shahu në bisedimet në të cilat nuk merr pjesë.<sup>57</sup>

Në përgjigje të shqetësimeve të Zogut, të dyja vendet nxituan t'i garantonin Zogut se në këtë marrëveshje nuk prekej Shqipëria. Madje, Ciano kishte udhëtuar personalisht në Shqipëri për të ofruar garancitë e nevojshme

<sup>54</sup> B. Krizman, *Vanjska politika jugoslovenske države 1919-1941*, 98.

<sup>55</sup> *Arkivi i Institutit të Historisë Prishtinë* (më tej: *AIH*) Fondi A-VII, Dokumente të Shqipërisë, 59.

<sup>56</sup> Živko Avramovski, "Jugoslovenski-Albanski odnosi 1918-139", *Ideje - Časopis teoriju savremenog društva* 5-6 (1987): 77-78.

<sup>57</sup> *TNA*, Fondi: FO 371/21113, Telegram i A. Ryan drejtuar Foreign Office, 1 prill 1937.

për objektivat e paktit italo-jugosllav. Regjimi i Zogut e shfrytëzoi këtë vizitë për të proklamuar “*miqësinë e thellë*” shqiptaro-italiane, por njëkohësisht e shfrytëzoi paktin për afrim me Jugosllavinë. Gjatë pranverës dhe verës të vitit 1937 u përvijua përpjekja shqiptare për arritjen e një marrëveshjeje ekonomike dhe politike me Jugosllavinë, por qeveria e Stojadinoviçit nuk reagoi ndaj një nisme të tillë. Gjatë një bisede me Cianon, Stojadinoviçi kishte bërë të ditur se refuzimi i kërkesës shqiptare ishte rezultat i perceptimit jugosllav të Shqipërisë si sferë e ndikimit italian.<sup>58</sup> Përmes kësaj marrëveshjeje Shqipëria e kishte humbur tanimë rëndësinë që ajo kishte në marrëdhëniet italo-jugosllave, pasi kjo e fundit faktikisht kishte pranuar mbizotërimin e të parës në Shqipëri. Momenti i rrëzimit përfundimtar të regjimit të Zogut po afrohej.<sup>59</sup>

Rrethanat e përgjithshme gjeopolitike nëpër të cilat po kalonte Evropa dhe nevoja për siguri politike dhe ekonomike nxiti Jugosllavinë që të braktiste Shqipërinë nën influencën italiane, një akt që ndryshoi rrënjësisht qasjen politike të Jugosllavisë ndaj Shqipërisë që nga viti 1919 e deri më 1937.

## Rilindja e mundësisë për okupimin e Shqipërisë së Veriut

Aksionet ushtarake gjermane si okupimi i Rinit (mars 1936),<sup>60</sup> aneksimi i Austrisë (mars 1938), pushtimi i krahinës Sudeteland në Çekoslllovakë (shtator 1938), etj.,<sup>61</sup> dhe reagimi i zbehtë i demokracive perëndimore bindën Musolinin se të njëjtat nuk do të reagonin as kundër okupimit italian të Shqipërisë. Okupimi italian i Shqipërisë ishte shndërruar në një objektiv jetik për Italinë, i kushtëzuar nga dy faktorë: pretendimet italiane në Evropën Qendrore ishin shuar si rezultat i pushtimeve gjermane dhe e dyta, këto pushtime kishin zbehur reputacionin italian. Prandaj, aktet e Hitlerit u shfrytëzuan si pretekst për të okupuar Shqipërinë, e me këtë akt të forconin pozitat e Italisë në Evropën Juglindore.<sup>62</sup>

<sup>58</sup> Jacob B. Hoptner, *Jugosllavia u krizi 1934-1941* (Michigan: Columbia University Press, 1964), 143.

<sup>59</sup> AK, Fondi: Memoaret XXVI, Kutia 1-90, dosja: Jovan Miliqeviç, 10.

<sup>60</sup> *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, Vol. XVI, Second Series, ed. Medlicott W. N, Dakin Douglas, and Lambert M. E (London: Her Majesty Stationary Office, 1977), 44.

<sup>61</sup> Owen Pearson, *Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy* (London: The Center for Albanian Studies & IB Tauris, 2004), 410.

<sup>62</sup> Biser Petrov, “British Policy towards Albania: April 1939-April 1941”, *Institut D’etudes Balkaniques* 4-2004 (2004): 52–53.

Për të realizuar planet e saj, Italia e pa të nevojshme që të parandalonte reagimin dhe që të siguronte pajtimin apo madje edhe bashkëpunimin e Jugosllavisë, vullneti i mirë i së cilës ishte ushqyer që nga koha kur Ciano e Stojadinoviç kishin nënshkruar marrëveshjen e marsit të vitit 1937. Bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve, nga këndvështrimi italian, ishte vlerësuar si një levë e dobishme për të përballuar presionin gjerman në drejtim të Adriatikut në rast të ndonjë pushtimi, apo ishte vlerësuar për të qenë faktor kryesor në regjionin e Danubit dhe të Ballkanit.<sup>63</sup>

Kah mesi i janarit të vitit 1939, ministri i Jashtëm Italian konti Ciano arriti për një vizitë disaditore në Beograd. Në takimin që e pati me kryeministrin jugosllav Stojadinoviç, më 19 janar 1939, teksa kishin shkuar së bashku në gjueti në malin Belje, Ciano e kishte hapur temën e çështjes së Shqipërisë. Në kujtimet e tij Stojadinoviç thekson se Ciano propozoi ndarjen e Shqipërisë midis Italisë e Jugosllavisë. Ai i ofroi Jugosllavisë një pjesë të territorit të Shqipërisë Veriore, dalje në Adriatik, madje edhe dalje në Egje, duke përfshirë Selanikun. Stojadinoviçin nuk e kishte bindur ideja e Selanikut për shkak të miqësisë tradicionale me Greqinë dhe të doganës së lirë jugosllave atje, por ishte joshur nga ideja e copëtimit të Shqipërisë, duke menduar se copëtimi nënkuptonte moslejimin që Italia të zotëronte Shqipërinë e vetme. Pastaj, në këtë ide përfshihej Shkodra – ambicia shekullore malazeze, miqtë e shumë të jugosllavë në Shqipërinë e Veriut, si dhe hekurudha, e cila do të lidhte Serbinë me Adriatikut, jo me Jugosllavinë si tërësi, por me Serbinë, sepse hekurudha për shkak të terrenit të vështirë nuk mund të realizohej pa kaluar një pjesë e saj në territorin shqiptar.<sup>64</sup>

Në këto diskutime Stojadinoviç kishte shprehur mendimin se janë dy zgjidhje të mundshme lidhur me Shqipërinë: (1) që Zogu të zëvendësohej nga një person i denjë edhe pse as vetë nuk e dinte se kush mund të ishte ky person, dhe (2) Shqipëria të ndahej midis Jugosllavisë e Italisë.<sup>65</sup> Megjithatë, Ciano e kishte kuptuar thelbin e pretendimeve të Stojadinoviçit. Në ditarin e tij ai shkruante se Stojadinoviç e konsideronte ndarjen e Shqipërisë si zgjidhjen më të mirë të çështjes së Shqipërisë.<sup>66</sup>

<sup>63</sup> Dragan Bakić, "The Port of Salonica in Yugoslav Foreign Policy", *Balkanica* 43-2012 (2012): 204.

<sup>64</sup> Stojadinoviç, *Ni rat ni pakt, Jugoslavia izmedju dva rata*, 570-571.

<sup>65</sup> Krizman, "Elaborat dra Ive Andrica o Albaniji iz 1939. Godine", *Časopis za suvremenu povijest* 9-1977 (1977): 80.

<sup>66</sup> *Dnevnik Groga Ciana* (Zagreb 1948), 32.

Por, ndryshe nga Stojadinoviçi, i cili e mendonte copëtimin klasik të Shqipërisë, Ciano përmes shprehjeve të kujdesshme nënkuptonte korrekturat e kufirit verior të Shqipërisë dhe mbështetjen e daljes së Jugosllavisë në Selanik e Egje kur kjo e fundit të vendoste për një gjë të tillë.<sup>67</sup> Sidoqoftë, qëllimet e të dy palëve çonin padyshim në eliminimin e faktorit shqiptar, respektivisht të Shqipërisë si shtet.<sup>68</sup>

Propozimi i Cianos e kishte ngazëllyer Stojadinoviçin, sa që menjëherë ai kishte nisur aksionin diplomatik të përgatitjes së terrenit për një marrëveshje të tillë. Ai kishte zhvilluar konsultime me zyrtarë të latë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Jugosllavisë, komandën ushtarake jugosllave dhe me princin Pavle. Bazuar në kërkesën e Stojadinoviçit, në kuadër të Ministrisë së Jashtme të Jugosllavisë ishin hartuar dy elaborate për nevoja të brendshme të kësaj ministrie lidhur me ndarjen e Shqipërisë. Elaborati i parë ishte hartuar nga Ivo Andriç<sup>69</sup>, ndërsa i dyti nga Ivan Vukotić,<sup>70</sup> që të dy zyrtarë të lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë.

“Elaborati i vitit 1939 i dr. Ivo Andriçit mbi Shqipërinë”, i datës 30 janar 1939, përfshin një studim të detajuar mbi Shqipërinë, të ndarë në dhjetë kapituj. Duke ofruar një vështrim historik mbi relacionet me Shqipërinë elaborati përqendrohet në tre çështje, të cilat direkt apo tërthorazi ndërlidhnin jo vetëm kufirin verior shqiptaro-jugosllav, por edhe të ardhmen politike të Jugosllavisë:

1. Precedenti i rrezikshëm – pretendimet italiane vlerësoheshin si një precedent i rrezikshëm sepse mund të hapeshin çështje tjera që ndërlidheshin

<sup>67</sup> Бојан Симић, “Посета грофа Ђана Југославији у јануару 1939. и пад Милана Стојадиновића”, *Архив - Часопис Архива Југославије* 1-2/2018 (2018): 71; *Dnevnik Groga Ciana*, 31.

<sup>68</sup> Emine Arifi Bakalli, *Drejt eliminimit të faktorit shqiptar në Ballkan* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2023), 300.

<sup>69</sup> Gjatë viteve 1937-1939 dr. Ivo Andriç në cilësinë e zyrtarit të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë ushtroi detyrën e zv/ministrit të kësaj ministrie. Andriç ishte njeriu i parë për nga hierarkia karrieriste në këtë ministri. Pas rënies së Stojadinoviqit ai u emërua ambasador i Mbretërisë së Jugosllavisë në Berlin, pozitë të cilën e ushtroi deri në luftën e prillit të vitit 1941... për më tepër shih:

[https://www.27mart.com/main.php?pages\\_id=110&languages\\_id=1](https://www.27mart.com/main.php?pages_id=110&languages_id=1), qasur më: 10 prill 2023.

<sup>70</sup> Ivan Vukotić, diplomat i lartë karriere. Në shërbimin diplomatik të Mbretërisë së Jugosllavisë ushtroi detyra me rëndësi, sidomos lidhur me Shqipërinë: konsull në Shkodër (1921-1926), këshilltar i legatës jugosllave në Tiranë (1926, 1932-1934), emisar special në Tiranë (1939), etj. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Malit të Zi..., për më tepër shih: <https://leks.canu.ac.me/web/ldcg.php?OID=3084>, qasur më: 10 prill 2023.

me Traktatin e Londrës së vitit 1915 dhe si rrjedhojë të afektonin territore tjera jugosllave: *“Okupimi i një pjese të territorit ballkanik nga një fuqi jo ballkanike, pa prapavijë etnike, paraqet si për ne ashtu edhe për popujt tjerë ballkanik një precedent të rrezikshëm. Fuqitë tjera nga drejtime tjera mund të paraqiten me pretendime të ngjashme. Sidomos çështja e Italisë në Shqipëri paraqet rrezik për ne, kur përmes Paktit të Londrës jugu i Shqipërisë i ishte njohur Italisë, dhe po të njëjtës Itali i ishte njohur edhe Dalmacia veriore. Precedenti për aktivizimin e dispozitave të Paktit të Londrës në një sektor të Ballkanit hap dyert për aktivizimin e dispozitave tjera”*.<sup>71</sup>

2. Ndarja e Shqipërisë – në këtë pikë duhej shmangur konflikti me Italinë dhe theksi vihej në sigurimin e Kosovës dhe të Malit të Zi: *“Në vlerësim të përgjithshëm duhet të kemi kujdes që në çdo rrethanë të shmangim konfliktin e hapur apo të fshehur me Italinë. Po ashtu duhet shmangur mundësinë që Italia e vetme ta okupojë Shqipërinë dhe të na rrezikojë në pika të ndjeshme sikurse Kosova dhe Boka e Kotorrit. Nga ajo që thamë, ndarja e Shqipërisë mund të paraqitet si opsion vetëm si një rrethanë e pashmangshme dhe si një dëm nga i cili mund të kursejmë aq sa mundemi”*.<sup>72</sup>

3. Kompensimet tona – çfarë mund të përfitonte Jugosllavia? Në këtë seksion përsëriten pretendimet e parashtruara rreth 20 vite më parë në bisedimet e Konferencës së Paqes: *“Këto kompensime gjenden në një material të hartuar rreth 20 vite më parë kur edhe ishte paraqitur çështja e ndarjes së Shqipërisë. Maksimumi që kishim kërkuar atëherë ishte kufiri që kalonte përgjatë lumenjve Mat dhe Drinit të Zi, i cili kufi do të na siguronte në aspekt strategjik Malin e Zi dhe Kosovën. Duhej të siguronim edhe luginat e liqeneve të Prespës e të Ohrit, përfshirë edhe Pogradecin dhe fshatrat sllave të Golo Berdes dhe atyre midis Prespës e Korçës”*.<sup>73</sup>

Sigurisht, kur kujtoheshin pretendimet e mëhershme nuk mund të anashkalohej Shkodra. Elaborati theksonte qartë përfitimet ekonomike: *“Marrja e Shkodrës në këtë rast do të na sillte rëndësi morale e ekonomike. Kjo do të na mundësonte realizimin e punimeve të mëdha hidroteknike dhe sigurimit të tokës pjellore për Malin e Zi. Shqipëria e Veriut në kuadër të Jugosllavisë do të mundësonte krijimin e lidhjeve të reja të komunikacionit midis Serbisë veriore dhe asaj jugore me Adriatikon”*.<sup>74</sup>

<sup>71</sup> Krizman, *“Elaborat dra Ive Andrica o Albaniji iz 1939. Godine”*, 89.

<sup>72</sup> Po aty, 89.

<sup>73</sup> Po aty.

<sup>74</sup> Po aty.

Andriçi nuk harroi as problemin etnik brenda kufijve të Mbretërisë së Jugosllavisë dhe politikës së saj të ndryshimit të strukturës etnike në trevat e banuara me shqiptarë, që pashmangshëm do të ndryshonte sipas rrethanave të reja: *“Me ndarjen e Shqipërisë do të zhdukej qendra e joshjes për pakicën kombëtare në Kosovë, e cila, në rrethana të reja, do të asimilohej më lehtë. Ne do t’i merrnim nja 200.000 - 300.000 shqiptarë, por shumicën të besimit katolik, relacionet e të cilëve me shqiptarët myslimanë nuk kanë qenë asnjëherë të mira. Çështja e shpërnguljes së shqiptarëve myslimanë në Turqi gjithsesi do të kryhej në bazë të rrethanave të reja pasi që nuk do të kishte asnjë pengesë për të parandaluar një aksion të tillë”*.<sup>75</sup>

Vetëm disa ditë më vonë, më 3 shkurt 1939, edhe Ivan Vukotić parashtroi elaboratin e tij lidhur me ndarjen e Shqipërisë. Qysh në hyrje të elaboratit të parashtruar Vukotić shprehej pozitivisht rreth mundësisë për aneksimin jo vetëm të veriut, por edhe të disa trevave të Shqipërisë së Mesme: *“Menjëherë, qysh me fillim theksoj se aneksimi i veriut dhe pjesëve të Shqipërisë së Mesme vendit tonë, paraqet njërën nga interesat jetësore të popullit tonë. Kjo do të nënkuptonte realizimin e aspiratave tona natyrale dhe plotësimin e dëshirave shekullore”*.<sup>76</sup>

Ndër argumentet pro ndarjes së Shqipërisë, Vukotić përmendi:

1. Populli shqiptar gjatë historisë së tij ka qenë një armë për politikën e huaj dhe për qëllime të huaja, si atyre turke, austriake e kohëve të fundit edhe italiane. Ata kurrë nuk janë solidarizuar me popujt ballkanik, ndërsa ne nuk kemi asnjë simpati për ta;

2. Përmes pozitës së saj gjeografike Shqipëria pengon zhvillimin ekonomik të shtetit jugosllav, kurse me copëtimin e Shqipërisë kufiri ynë tokësor në raport me detin do të shkurtohej për 300 kilometra;

3. Shteti dhe monarkia shqiptare janë qendër gravitacioni për një numër të konsiderueshëm të shqiptarëve që banojnë përgjatë kufirit. Me anë të aneksimit do të ngulfatej irredentizmi shqiptar, që është i rrezikshëm për viset tona jugore. Elementi luftarak shqiptar në territorin që nga lindja drejt perëndimit do t’i destinohej asimilimit të lehtë;

4. Kurdoherë që është folur për ndarjen e Shqipërisë, kërkesat tona maksimale shkonin deri tek lugina e lumit Shkumbin. Gjithsesi, linja Strugë-Librazhd-Elbasan-Durrës do të kënaqte plotësisht kërkesat tona.<sup>77</sup>

<sup>75</sup> Po aty.

<sup>76</sup> Po aty, 80.

<sup>77</sup> Po aty, 80-81.

Përveç arsytetimeve të cekura më sipër, Vukotić ofroi edhe një pasqyrë të shkurtër të përpjekjeve historike për ndarjen e Shqipërisë nga perspektiva e tij si diplomat pjesëmarrës në disa zhvillime diplomatike dhe si njohës i mirë i çështjes shqiptare pasi që për një kohë të gjatë kishte shërbyer në shërbimin diplomatik jugosllav përfshirë edhe akreditimin në Shqipëri. “*Në gjitha përpjekjet tona politike-diplomatike*”, theksonte Vukotić, “*ne jemi angazhuar për pengimin e formimit të shtetit shqiptar, pasi që një shtet i tillë do të ishte kundër pretendimeve tona kombëtare*”.<sup>78</sup> Si shembuj të përpjekjeve të tilla apo për copëtimin e Shqipërisë, Vukotić kishte listuar: “*Në korrik të vitit 1921 derisa Konferenca e Ambasadorëve po trajtonte kufijtë e Shqipërisë Pashiçi ishte pajtuar me italianët për copëtimin e Shqipërisë me kushtin që të kemi përfitime më të mira se ato që parashihte Pakti i Londrës i vitit 1915. Por qeveria jonë nuk ishte pajtuar dhe ideja dështoi. Një ofertë për ndarjen e Shqipërisë midis Jugosllavisë dhe Italisë ishte parashtruar në vitin 1924 nga diplomati italian Kontarini, kurse zhvillime të ngjashme ishin bërë edhe në vitin 1926 por që dështuan*”.<sup>79</sup>

Krejt në fund Vukotić dha rekomandimin se duhej shfrytëzuar situatën e volitshme dhe me ndarjen e Shqipërisë të realizohet një pretendim i madh popullor.<sup>80</sup>

Është me rëndësi të përmendet edhe qëndrimi i ministrit fuqiplotë jugosllav në Tiranë, Jankoviç. Jankoviçi, i cili deri vonë kundërshtonte çdo marrëveshje me Italinë, kishte ndryshuar qëndrim. Sigurisht ndryshimi i qëndrimeve kishte të bënte me instruksionet që kishte marr nga Stojadinoviç, me të cilin kishte edhe miqësi personale. Ky mendonte se zona e interesit italian në Shqipëri duhej të “kufizohej në zonën bregdetare të Shqipërisë ku gjendej pjesa më e madhe e kompensimeve italiane”, ndërsa pjesa tjetër t’i mbetej Jugosllavisë. Ndarjen e Shqipërisë me Italinë e arsyetonte me faktin se kjo tashmë ishte de fakto brenda Shqipërisë, fakt të cilin Jugosllavia duhej ta merrte parasys.<sup>81</sup>

Ndryshe nga kërkesa për diplomatët, Stojadinoviç u kishte drejtuar ushtarakëve një pyetje më të ndërlikuar. Në letrën që i dërgoi ministrit të Ushtrisë, 26 janar 1939, ai nuk u shpreh hapur për planin e copëtimit të Shqipërisë që buronte nga biseda me Cianon. Ai ishte shprehur se qeveria italiane ishte

<sup>78</sup> Po aty.

<sup>79</sup> Po aty.

<sup>80</sup> Po aty.

<sup>81</sup> Bakalli, *Drejt eliminimit të faktorit shqiptar në Ballkan*, 306.

e pakënaqur me Zogun dhe se e kishte humbur besimin në të, se flitej për një kryengritje kundër Zogut gjatë pranverës, duke pyetur më pas se cilat ishin masat që parashikonte t'i ndërmerre ushtria në një situatë të tillë.<sup>82</sup> Bazuar në kërkesën e Stojadonoviç, ministri i Ushtrisë iu drejtua strukturave më të larta ushtarake të cilat pas një analize hartuan raportin për planet ushtarake në rast të situatave të tilla.<sup>83</sup> Kreu i ushtrisë mbretërore jugosllave, gjenerali Dushan Simoviç, preferonte qëndrimin neutral të ushtrisë jugosllave në rast të ndërhyrjes italiane në Shqipëri. Në mbrojtje të këtij qëndrimi ai dha disa arsye: ndërhyrja ushtarake jugosllave në Shqipëri do të shkonte në favor të Italisë. Ajo do të pushtonte limanet, bregun e Adriatikut dhe rajonet e pasura me naftë e minerale, kurse Jugosllavia si shpërblim do të fitonte viset e varfra me një popullsi luftarake e cila do ta mbante gjithnjë ushtrinë jugosllave në gjendje gatishmërie e kjo do t'i kushtonte financiarisht Jugosllavisë krahas rritjes së numrit të shqiptarëve në këtë shtet.<sup>84</sup>

Sidoqoftë, nëse një ndërhyrje ushtarake do të ishte e nevojshme, Simoviçi, më 7 mars 1939 prezantoi planin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Jugosllavisë mbi zonat e interesit jugosllav. Në këto zona hynin territoret midis kufirit ekzistues shqiptaro-jugosllav dhe lumit Shkumbin, pra pjesë të Shqipërisë veriore dhe asaj të mesme.<sup>85</sup>

Megjithatë, rekomandimet e diplomatëve dhe ushtarakëve nuk do të kishin asnjë rëndësi nëse nuk do të konsultoheshin regjenti Pavle, si kreu i shtetit. Në një çështje të ndërlikuar sikurse kjo, për të cilën nuk mund të vendosej brenda një dite, Stojadinoviç udhëzoi Cianon që të fliste edhe me princin Pavle. Stojadinoviç e dinte se princi Pavle mund të kishte qëndrim negativ rreth ndarjes së Shqipërisë. Dyshimet e Stojadinoviçit dolën të sakta. Pavle nuk dha asnjë përgjigje definitive përveç një fraze të ftohtë: “*Ne kemi mjaft shqiptarë brenda kufijve tanë, kemi shumë shqetësime me ta, dhe nuk jemi të interesuar ta shtojmë numrin e tyre*”.<sup>86</sup>

<sup>82</sup> Avramovski, “Pitanje podela Albanije u razgorima Stojadonović-Ciano januara 1939 i stav nekih diplomatskih i vojnih ličnosti”, *Godišnjak 1-1965* (1965): 151-152.

<sup>83</sup> Krizman, “Italija u politici kralja Aleksandra i kneza Pavle (1918-1941)” *Časopis za suvremenu povijest*, 7-1 (1975): 152.

<sup>84</sup> Bakalli, *Drejt eliminimit të faktorit shqiptar në Ballkan*, 311-312.

<sup>85</sup> Avramovski, “Pitanje podela Albanije u razgorima Stojadonović-Ciano januara 1939 i stav nekih diplomatskih i vojnih ličnosti”, 155-157.

<sup>86</sup> Krizman, “Italija u politici kralja Aleksandra i kneza Pavle (1918-1941)”, 79-80.

Sidoqoftë, këto plane nuk u realizuan. Qeveria e Stojadinoviçit u rrëzua më 4 shkurt 1939.<sup>87</sup>

Shtrohet pyetja: a kishte lidhje shkarkimi i Stojadinoviçit me vizitën e Cianos? Dokumentet e legatës britanike në Beograd japin një përgjigje pothuaj të qartë. Princi Pavle e kishte idenë për të zëvendësuar Stojadinoviçin qysh para ardhjes së Cianos në Beograd. Pavle i kishte deklaruar ministrit britanik në Beograd se arsyet kryesore për zëvendësimin e tij ishin prirjet diktatoriale, se po punonte kokë me vete dhe se lideri kroat Maçek refuzonte çfarëdolloj bashkëpunimi me Stojadinoviçin. I njëjti dokument thekson se Pavle kishte frikë nga reagimi i Berlinit dhe Romës lidhur me rrëzimin e tij prandaj edhe kishte pritur një kohë të përshtatshme.<sup>88</sup>

Rënia e Stojadinoviçit ndryshoi edhe qëndrimin e Musolinit. Italia garancinë e realizimit të marrëveshjes e shihte tek Stojadinoviçi, prandaj në rrethana të tjera, duke dyshuar në qëndrimet e qeverisë së re jugosllave, aksionin e saj në Shqipëri e shihte pa ndihmën e Jugosllavisë, madje po të ishte nevoja edhe kundër saj. Musolini e Ciano ishin pajtuar në parim që në javën e Pashkëve të vepronin në drejtim të okupimit të Shqipërisë.<sup>89</sup>

Në vazhden e përgatitjes për pushtimin e Shqipërisë kah fundi i marsit 1939 Italia i paraqiti qeverisë shqiptare një kërkesë për arritjen e një marrëveshjeje përmes së cilës Shqipëria në mënyrë vullnetare do të pranonte protektoratin italian. Shqipëria nxitoi të kërkonte ndihmën ushtarake jugosllave, por Beogradi nuk iu përgjigj një kërkesë të tillë. Përveç se shpresonte të përfitonte diçka nga ato që u biseduan me Cianon, Beogradi nuk mund t'i lejonte vetes një kundërshtim të hapur të agresionit italian, sidomos kur në kufijtë e vet, tanimë ndodhej rreziku gjerman.<sup>90</sup> Njofimit të ministrit shqiptar në Beograd se Italia po përgatitej të pushtonte Shqipërinë, qeveria jugosllave iu përgjigj me këtë shprehje: “...qeveria jugosllave beson se Italia vetëm po aktron dhe se nuk e ka për qëllim që ta pushtojë Shqipërinë...”.<sup>91</sup> Sigurisht që, një prononcim i tillë kishte qenë vetëm një arsyetim sa për të amortizuar kërkesat shqiptare. Qëndrimi i qeverisë jugosllave lidhur me kërcënimet ital-

<sup>87</sup> “Оставка владе г. др. Милана Стојадиновића”, Политика, 5.2.1939:1.

<sup>88</sup> Avramovski, *Britanci o Kraljevini Jugoslavije*, Tom III (Beograd: Arhiv Jugosllavije, 1996), 53.

<sup>89</sup> *Dnevnik Gropa Ciana*, 35-38.

<sup>90</sup> Puto, *Shqipëria Politike* (Tiranë: Toena, 2009), 639.

<sup>91</sup> *Foreign Relations of the United States Diplomatic Papers- the British Commonwealth and Europe 1939, Volume II* (Washington: US Printing House, 1939), 373.

iane ndaj Shqipërisë mund të kuptohet nga deklarata e ministrit të Jashtëm jugosllav, Cincar Markoviç, pas vizitës së tij në Berlin: “...*çështja shqiptare nuk mund të zgjidhet përmes Tiranës, por vetëm përmes Romës*”.<sup>92</sup>

Qeveria e re jugosllave nuk kishte guxim të kundërshtonte aksionin italian dhe, e pranoi qetësisht pushtimin italian të Shqipërisë. Çështjen e ndarjes së Shqipërisë e as atë të ndërhyrjes nuk e përmendi më askush. Në këtë qëndrim mund të ketë ndikuar edhe Princi Pavle, i cili gjatë bisedës me Cianon, jo vetëm që nuk kishte kundërshtuar projektin italian, por në aneksimin e një pjese të Shqipërisë ai kishte parashikuar rrezikun shqiptar,<sup>93</sup> si një problem shtesë, në një kohë kur Jugosllavia po përballej me vështirësi të ndryshme si rreziku nga jashtë, paqëndrueshmëria e brendshme politike dhe kriza ekonomike.

Një faktor tjetër, që mund të ketë ndikuar në qëndrimin pasiv të ushtrisë jugosllave kundrejt pushtimit italian të Shqipërisë, është edhe përgatitja e dobët e ushtrisë jugosllave. Ky argument mund të bazohet në një raport të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, të datës 20 nëntor 1938. Aty ndër të tjera thuhej: “*As që mund të mendohet se ushtria jonë mund të luftojë kundër fqinjëve tanë, të cilët janë të armatosur mirë..., ushtrisë sonë i mungojnë armatimet dhe materialet luftarake. Kemi një mungesë të armatimeve që shkon deri në shkallën 60-80%, forcat ajrore nuk janë në gjendje t’i kryejnë detyrat e tyre, kemi vetëm 12 bateri të armatimit të rëndë, kurse motorizimi ushtarak është në gjendje të mjerueshme*”.<sup>94</sup>

Në aspektin ushtarak, edhe pse në planet e saj ushtarake Jugosllavia gjithmonë parashihte një reagim të fuqishëm në rast të pushtimit italian të Shqipërisë, kur Italia e sulmoi Shqipërinë më 7 prill të vitit 1939,<sup>95</sup> ushtria jugosllave reagoi vetëm duke përforcuar trupat kufitare në kufi me Shqipërinë. Kjo politikë dëshmoi se tashmë Jugosllavia ishte orientuar nga Blloku Qendror.<sup>96</sup>

Një faktor tjetër që ndikoi heshtjen jugosllave ishin edhe masat paraprake që kishte ndërmarrë Ciano. Në tentativë për të paralizuar çdo reagim ushtarak jugosllav, Ciano kishte rënë në ujdë me Hungarinë që 6 divizione ushtarake

<sup>92</sup> AIH, Fondi: A-VII, Dokumente të Shqipërisë, 60.

<sup>93</sup> Hoptner, *Jugosllavia u krizi 1934-1941*, 149.

<sup>94</sup> Dragan Tešić, “Ratni planovi vojske Kraljevine Jugoslavije 1938-1941 godine”, *Vojnoistorijski glasnik* 1-XLII (1991): 38.

<sup>95</sup> AK, Fondi: Arkivi Diplomatič Beograd, Kutia 3, 33.

<sup>96</sup> Avramovski, “Jugoslovenski-Albanski odnosi 1918-1939”, 79.

hungareze të ishin në gjendje gatishmërie për të ndërhyrë në Jugosllavi në rast të reagimit jugosllav ndaj aksionit italian në Shqipëri.<sup>97</sup>

Heshtja u shoqërua edhe karshi veprimeve tjera italiane në Shqipëri. Beogradi pranoi në heshtje aktin e aneksimit, bashkimit personal të Shqipërisë me Italinë.<sup>98</sup> Më 9 gusht 1939 qeveria jugosllave mori vendimin për mbylljen e ambasadës jugosllave në Tiranë dhe hapjen e një konsullate të përgjithshme në këtë vend. Me këtë akt Jugosllavia e pranoi okupimin dhe bashkimin personal të Italisë me Shqipërinë, akt të cilin e kishin miratuar edhe shtetet tjera evropiane.<sup>99</sup>

---

<sup>97</sup> Velimir Terzić, *Slom Kraljevine Jugoslavije 1941* (Beograd: Narodna knjiga, 1982), 241.

<sup>98</sup> Puto, *Shqipëria Politike*, 650-651.

<sup>99</sup> Avramovski, "Jugoslovenski-Albanski odnosi 1918-139", 79.

**Bibliografi:****Burimet arkivore:****Arkivi i Kosovës:****Fondet:**

- P. Millovanoviç-Beograd, nr. inv. 132, kutia 3, Revista e Lidhjes së Kombeve;
- Arkivi i ish ushtrisë së Jugosllavisë, Elaborat 20, Popisnik 17, vitet 1920-1941;
- Memoaret XXVI, Kutia 1-90, dosja: Jovan Miliqeviç;
- Arkivi Diplomatik Beograd, Kutia 3.

**Arkivi i Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë:****Fondi:**

- A-VII, Dokumente të Shqipërisë.

**The National Archives London:****Fondet:**

- FO 371/5726, 1921;
- FO 371/5735, 1921;
- FO 371/21113, 1937.

**Burimet e botuara:**

- *Britanci o Kraljevini Jugosllavije*, Tom III, ed. Avramovski Živko, Beograd: Arhiv Jugosllavije, 1996.
- *British Documents on the Origin of the War 1898-1914, Vol. IX, Part I*, ed. G.P. Gooch & Harold Temperley, London: H.M. Stationery Office, 1933.
- *Documents on British Foreign Policy 1919-1939*, Vol. XVI, Second Series, ed. Medlicott W. N, Dakin Douglas, and Lambert M. E., London: Her Majesty Stationary Office, 1977.
- *Dnevnik Gropa Ciana*, Zagreb 1948.
- *Foreign Relations of the United States Diplomatic Papers*, General Volume I (Washington: US Printing House 1933).
- *Foreign Relations of the United States Diplomatic Papers- the British Commonwealth and Europe 1939, Volume II*, Washington: US Printing House, 1939.

**Monografi & Punime shkencore:**

- Avramovski Živko, “Pitanje podela Albanije u razgorima Stojadonović-Ciano januara 1939 i stav nekih diplomatskih i vojnih ličnosti”, *Godišnjak* 1-1965.

- Avramovski Ž., “Jugoslovenski-Albanski odnosi 1918-1939”, *Ideje - Časopis teoriju savremenog društva* 5-6-1987.
- Bakalli Arifi Emine, *Drejt eliminimit të faktorit shqiptar në Ballkan*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2023.
- Bakić Dragan, “The Port of Salonica in Yugoslav Foreign Policy”, *Balkanica* 43-2012.
- Bataković T. Dušan, *Qeveria serbe dhe Esat Pashe Toptani*, Tiranë: Botimet IDK, 2012.
- Војводић Михаило, *Србија и Албанско питање крајем XIX Века*, vol. Књига 15, Београд: Српска Академија Наука и Уметности, Одељење Историјских Наука, 1990.
- Cabanes Pierre et.al, *Historia e Adriatikut*, Tiranë: Shtëpia botuese IDK, 2005.
- Castellan Georges, *Histori e Ballkanit*, Tiranë: Çabej, 1997.
- Симић Бојан, “Посета грофа Ђана Југославији у јануару 1939. и пад Милана Стојадиновића”, *Архив - Часопис Архива Југославије* 1-2/2018.
- Страњаковић Драгослав, *Како је постало Гарашаниново «Начертаније»*, Београд: Споменик СКА, 1939.
- Culaj Lush, *Çështja shqiptare ne Konferencën e Parisit 1919-1920*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2010.
- Çami Muin, Verli Marenglen, *Shqiperia ne Konferencen e Paqes (1919-1920)*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2015.
- Čulinović Ferdo, *Jugoslavija između dva rata*, Knjiga II, Zagreb: Jugoslovenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, 1961.
- Hadri Arber, *Presidenti Vilson dhe çështja shqiptare (Politika e SHBA në Konferencën e Paqes në Paris 1919-1920)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2012.
- Hall C. Richard, *The Balkan Wars 1912-1913: Prelude to the First World War*, London, New York: Routledge, 2000.
- Hoptner B. Jacob, *Jugoslavija u krizi 1934-1941*, Michigan: Columbia University Press, 1964.
- Islami Hivzi, *Spastrimet etnike-politika gjenocidiale serbe ndaj shqiptareve*, Pejë: Dukagjini, 2003.
- Kraja Mehmet et.al, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës*, I, A-K, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2018.
- Krizman Bogdan, *Vanjska politika jugoslovenske države 1919-1941- Diplomatski istorijski pregled*, Zagreb, 1975.
- Krizman B., “Italija u politici kralja Aleksandra i kneza Pavle (1918-1941)” *Časopis za suvremenu povijst*, 7/1-1975.
- Krizman B., “*Elaborat dra Ive Andrica o Albaniji iz 1939. Godine*”, *Časopis za suvremenu povijest* 9-1977.
- Krizman B., Hrabak Bogumilj, *Zapisnici sa sednica delegacije Kraljevine SHS*

- na Mirovnoj Konferenciji u Parizu 1818-1920*, Beograd: Institut Društvenih Nauka, 1960.
- Krleža Miroslav et.al, *Enciklopedija Jugoslavije*, Zagreb: Leksikografski Zavod FNRJ, 1958.
- L. S. Stavrianos, *The Balkans since 1453*, London: Hurst, 2002.
- Lukać Dušan, *Treći Rajh i zemlje jugoistočne Evrope*, Prvi deo 1933-1936, Beograd, 1982.
- Mcmillan Margaret, *Paris 1919 gashtë muaj që ndryshuan botën*, Tiranë: Plejad, 2006).
- Milo Paskal, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1919-1927*, Tiranë: Botimet enciklopedike, 1992.
- Milo P., *Politika e jashtme e Shqipërisë*, Tiranë: Toena, 2013.
- Милутин Д. Лазаревић, Наши ратови за ослобођење и уједињење. Српско-Турски рат 1912. године, књ. II (Београд: Српска Књижевна Задруга, 1929.
- Mousset Albert, *Shqipëria përballë Evropës (1912-1929)*, Tiranë: Dituria, 2004.
- Pearson Owen, *Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy*, London: The Center for Albanian Studies & IB Tauris, 2004.
- Petrov Biser, “British Policy towards Albania: April 1939-April 1941”, *Institut D’etudes Balkaniques* 4-2004.
- Prifti Kristaq et.al, *Historia e Popullit Shqiptar*; Vëllimi III, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007.
- Puto Arben, *Shqipëria Politike*, Tiranë: Toena, 2009.
- Puto A., *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha*, Tiranë: Toena, 2012.
- Rexha Sabri, *Raportet shqiptaro-serbe në Kosovë*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011.
- Rushiti Liman, “Rezistenca e popullit shqiptar kundër pushtuesve serbo-malazezë 1912-1914”, *Kosova* 24-25/2002-2003.
- Silajxhiç Haris, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit*, Tiranë: Dituria, 1991.
- Stojadinović Milan, *Ni rat ni pakt, Jugosllavia izmedju dva rata*, Buenos Aires, 1963.
- Swire Joseph, *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005).
- Šišić Ferdo, *Jadransko pitanje na Konferenciji Mira u Parizu, Zbirka akata i dokumenata*, Zagreb: Izvanredno izdanje matice Hrvatske, 1920.
- Teli Dibra Pranvera, *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927*, Tiranë: Neraida, 2005.
- Teli Dibra P., “Diplomacia angleze dhe vendimi i 9 nëntorit të vitit 1921 për Shqipërinë”, *Studime Historike* 3-4/2002.

- Terzić Velimir, *Slom Kraljevine Jugoslavije 1941*, Beograd: Narodna knjiga, 1982.
- Tešić Dragan, “Ratni planovi vojske Kraljevine Jugoslavije 1938-1941 godine”, *Vojnoistorijski glasnik* 1-XLII, 1991.
- Todorović Desanka, *Jugoslavija i Balkanske Države 1918-1923*, Beograd: Institut za Savremenu Istoriju, 1979.
- Turbedar Erhan, “Understanding ambitious and expansionist approaches in the proces leading to the Balkan Wars through the Railway exmple”, *The Centenary of Balkan Wars (1912-1913)*, Vol. 2, ed. Mustafa Turkeş, Ankara: Turk Tarih Kurumu, 2014.
- Uka Sabit, “Planet antishqiptare të shteteve fqinje në shekullin XIX”, *Shqiptarët në rrjedhat ballkanike*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1996.
- Vanku Milan, *Mala Antanta 1920-1938*, Titovo Užice, 1969.
- Verli Marenglen, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 1992.
- Vinaver Vuk, “Italijanska akcija protiv Jugoslavije na albanskoj-crnogorskoj granici 1918-1920”, *Istorijski zapisi* 3-1966.
- Vlora Qemal Ismail, *Kujtime*, Tiranë: Botimet Toeana, 1997.

### Shtypi:

- “Оставка владе г. др. Милана Стојадиновића”, *Политика*, 5.2.1939.

### Citime nga interneti:

- Дедијер Јевто, “Стара Србија географска и етнографска слика (1912.)”, qasur më 10 prill 2023, <https://dokumen.tips/download/link/dr-jevto-dedijer-stara-srbija-geografaska-i-etnografaska-slika.html>
- [https://www.27mart.com/main.php?pages\\_id=110&languages\\_id=1](https://www.27mart.com/main.php?pages_id=110&languages_id=1), qasur më: 10 prill 2023.
- <https://leks.canu.ac.me/web/ldcg.php?OID=3084>, qasur më: 10 prill 2023.

**Armend MEHMETI**

The Institute of History “Ali Hadri”

Email: armend.mehmeti@gmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0000-0002-9904-0963>

KUD: 94(496.5-17)“1912/1939”(05)

**SUMMARY****NORTHERN ALBANIA IN THE SERBIAN/YUGOSLAV  
OCCUPATION PROJECTS (1912-1939): BETWEEN  
AMBITION AND RESTRAINT**

Historically, the emergence and strengthening of the Serbian state included claims for access to the Adriatic Sea. This goal could be realized by occupying Northern Albania. Efforts to accomplish this claim were undertaken militarily in 1912-13 and again after World War I, yet they met with failure. Despite to the Serbian/Yugoslav military strength, the international circumstances at the time prevented the accomplishment of such ambitions. The 1930s in the 20th century marked a shift in global political circumstances. The aggressive assertion of claims by Germany and Italy, alongside the weak response from Western democracies, fostered an environment where the long-standing Serbian/Yugoslav aspiration for access to the Adriatic could resurface. In 1939, Italy presented Yugoslavia with this chance through the partition of Albania. In contrast to the period of 1912-1921, during the late 1930s, the Kingdom of Yugoslavia was not politically, militarily, or economically equipped to undertake ambitions for the annexation of Northern Albania. Regent Pavle was reluctant to increase the Albanian population in his kingdom by dividing and annexing portions of Albania. He also had concerns about escalating international tensions, which led him to dismiss Prime Minister Stojadinovic, a proponent of this idea, at a crucial time. With Stojadinovic's departure, the plans and discussions with Italy failed, as they viewed him as a key supporter of the initiative. The evaluations of the Yugoslav military also held a significant position in the Yugoslav stance. They acknowledged their lack of preparation and armament for engaging in a conflict with neighbouring countries, advocating for a neutral position. However, they argued that if Albania were to be divided, Yugoslavia would acquire land inhabited

by a resilient population, which would consistently keep the Yugoslav army stand-by, despite the fact that the new territories would lack economic value. Additionally, Yugoslavia encountered significant internal political turmoil. Ultimately, Yugoslavia chose to maintain a neutral stance and passively acquiesced to the Italian takeover of Albania. These findings support the notion that geopolitical factors play a crucial role in international relations and national goals.